

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA LEPURI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesat nr. 17829/23 dhe 7 të tjera –
shihni tabelën bashkëngjitur)

VENDIM

STRASBURG
31 mars 2026

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Lepuri dhe të tjerë kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komiteti i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetar,*

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelar i Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesat kundër Republikës së Shqipërisë të depozituara në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) nga kërkuesit e listuar në tabelën bashkëlidhur (“kërkuesit”), në datat e ndryshme që tregohen në të;

vendimin për të njoftuar për kërkesat Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar nga Agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 10 dhjetor 2026,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështjet në fjalë kanë të bëjnë me disa procese në gjykatat e brendshme, ku kërkuesit kanë depozituar ankimet e tyre kushtetuese kundër vendimeve të Gjykatës së Lartë të marra në çështjet e tyre përkatëse. Në të gjitha çështjet, Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim moskalimi në seancë për ankimet kushtetuese të kërkuesve, për shkak se janë depozituar jashtë afatit kohor katërmujor, duke e llogaritur afatin nga data e marrjes së vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data e marrjes dijeni nga kërkuesit në mënyrë efektive.

2. Në kërkesat nr. 17829/23, 19482/23, 19983/23, Gjykata Kushtetuese u shpreh që kur një palë kërkonte të merrte një kopje të vendimit, gjykata që kishte marrë vendimin në fjalë, e vuloste dhe që kjo vulë nuk mund të shërbente si provë vendimtare e datës së marrjes dijeni për herë të parë të palës me vendimin e kundërshtuar. Gjykata Kushtetuese vlerësoi që i takonte palës të provonte se vendimi i kundërshtuar nuk i ishte dorëzuar në një datë të mëparshme.

3. Në kërkesat nr. 19983/23, 26353/23, 38576/23, 4427/24, 6470/24, dhe 26336/24, Gjykata Kushtetuese, gjithashtu, u shpreh që avokatët e kërkuesve nuk i kishin dhënë Gjykatës së Lartë adresat e postës së tyre elektronike, për qëllim të njoftimit të tyre mbi vendimet e asaj gjykate.

4. Më 23 mars 2021, u prezantua ligji nr. 44/2021, që ndryshoi Kodin e Procedurës Civile, i cili parashikonte njoftimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë me anë të postës elektronike. Ky ligj hyri në fuqi më 29 maj 2021.

I. LEPURI, nr. 17829/23

5. Çështja ka të bëjë me proceset penale kundër kërkuesit, ku ai u dënua me njëzet vjet burg për vrasje të mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje. Në këto procese, kërkuesi depozitoi rekurs në Gjykatën e Lartë më 18 maj 2026 dhe kjo e fundit e mbledhur *in camera* e rrëzoi më 21 prill 2022. Kërkuesi mori vendimin e Gjykatës së Lartë më 27 shtator 2022, pas kërkesës së avokatit të tij drejtuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë. Kërkuesi depozitoi ankim kushtetues më 11 nëntor 2022 dhe parashtrime shtesë më 2 dhjetor 2022. Më 3 shkurt 2023, Gjykata Kushtetuese mori vendim moskalimi në seancë gjyqësore, për shkak të kalimit të afatit katërmujor, duke e llogaritur nga data e marrjes së vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë.

II. BRAHO, nr. 19482/23

6. Çështja ka të bëjë me një mosmarrëveshje punësimi ku gjykata e shkallës së parë dhe të dytë kanë vendosur në favor të kërkuesit. Më 4 janar 2017, pala kundërshtare depozitoi rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila më 17 mars 2022, e mbledhur *in camera* shfuqizoi vendimet e gjykatave më të ulëta. Kërkuesi mori vendimin e Gjykatës së Lartë më 14 tetor 2022, pas

kërkesës së avokatit të tij drejtuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë. Kërkuesi depozitoi ankim kushtetues më 7 nëntor 2022. Më 19 dhjetor 2022, Gjykata Kushtetuese mori vendim moskalimi në seancë gjyqësore, për shkak të kalimit të afatit katërmujor, duke e llogaritur nga data e marrjes së vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë.

III. KULE, nr. 19983/23

7. Çështja ka të bëjë me proceset penale kundër kërkuesit ku ai u dënua me njëzet e pesë vjet burg për vrasje dhe armëmbajtje pa leje. Në këto procese, kërkuesi depozitoi rekurs në Gjykatën e Lartë më 25 prill 2016 dhe kjo e fundit e mbledhur *in camera* e rrëzoi më 22 prill 2022. Kërkuesi e mori vendimin e Gjykatës së Lartë më 31 gusht 2022, pas kërkesës së avokatit të tij drejtuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë. Kërkuesi depozitoi ankim kushtetues më 21 nëntor 2022. Më 17 janar 2023, Gjykata Kushtetuese mori vendim moskalimi në seancë gjyqësore, për shkak të kalimit të afatit katërmujor, duke e llogaritur nga data e marrjes së vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë.

IV. MALLTEZI, nr. 26353/23

8. Çështja ka të bëjë me një mosmarrëveshje civile ndërmjet palëve private ku kërkuesi kërkoi shpërblim për shpifje. Në këto procese, kërkuesi depozitoi rekurs në Gjykatën e Lartë më 19 dhjetor 2014. Avokati i kërkuesit i dha Gjykatës së Lartë adresën e tij të postës elektronike. Më 8 qershor 2022, Gjykata e Lartë e mbledhur *in camera* e rrëzoi rekursin e kërkuesit, dhe në të njëjtën datë e publikoi dispozitivin e vendimit në faqen e saj të internetit. Vendimi i arsyetuar u depozitua në sekretarinë e Gjykatës së Lartë (dhe u vu në dispozicion të palëve) më 12 korrik 2022. Kërkuesi e mori vendimin më 14 shtator 2022, pas kërkesës së avokatit të tij drejtuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë.

9. Më 19 dhjetor, kërkuesi depozitoi ankim kushtetues dhe më 22 shkurt 2023 Gjykata Kushtetuese mori vendim moskalimi në seancë gjyqësore, për shkak se ishte me depozituar jashtë afatit kohor katërmujor, duke e llogaritur afatin nga 12 korriku 2022.

V. GURALUMI, nr. 38576/23

10. Çështja ka të bëjë me një konflikt pronësie. Kërkuesja depozitoi rekurs në Gjykatën e Lartë më 16 nëntor 2015. Më 8 shtator 2022, Gjykata e Lartë mori vendimin *in camera*. Më 25 janar 2023, kërkuesja i dërgoi shkresë Gjykatës së Lartë me anë të së cilës kërkonte informacion për ecurinë e çështjes së saj. Gjykata e Lartë u përgjigj me shkresë më 31 janar 2023 dhe i bashkëngjiti shkresës edhe vendimin e saj. Kërkuesja pretendoi se e kishte marrë shkresën më 2 shkurt 2023.

11. Më 24 prill 2023, kërkuesja depozitoi ankim kushtetues dhe më 8 qershor 2023 Gjykata Kushtetuese mori vendim moskalimi në seancë gjyqësore, për shkak se ishte depozituar jashtë afatit kohor katërmujor, duke e llogaritur afatin nga data e marrjes së vendimit të Gjykatës së Lartë.

VI. ÇELA, nr. 4427/24

12. Çështja ka të bëjë me procese penale kundër kërkueses ku ajo dënohet me tre vjet dhe katër muaj burg për mashtrim dhe shpërdorim detyre. Në këto procese, kërkuesja depozitoi rekurs në Gjykatën e Lartë më 22 korrik 2016. Avokati i kërkueses i dha Gjykatës së Lartë adresën e tij të postës elektronike. Gjykata e Lartë, e mbledhur *in kamera*, mori vendimin më 24 shkurt 2022 dhe e publikoi vendimin e arsyetuar në faqen e saj të internetit më 16 prill 2022. Kërkuesja e mori vendimin më 6 shtator 2023, pas kërkesës së asaj drejtuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë, në lidhje me çështjen e saj.

13. Kërkuesja depozitoi një ankim kushtetues më 21 shtator 2023 dhe Gjykata Kushtetuese mori vendim moskalimi në seancë gjyqësore më 23 nëntor 2023, për shkak se ishte depozituar jashtë afatit kohor katërmujor, duke e llogaritur afatin nga 16 prilli 2022.

VII. BALLA, nr. 6470/24

14. Çështja ka të bëjë me një konflikt pronësie. Më 28 prill 2014, kërkuesi depozitoi rekurs në Gjykatën e Lartë. Më 14 shtator 2022, avokati i kërkuesit i dha Gjykatës së Lartë adresën e

postës elektronike të tij dhe kërkoi që vendimi i Gjykatës së Lartë t'i dërgohej në atë adresë. Gjykata e Lartë e mbledhur *in camera* e rrëzoi ankimin e kërkuarit më 26 shtator 2022. Gjykata e Lartë nuk e dërgoi në adresën e postës elektronike të kërkuarit, por ia njoftoi kërkuarit më 2 qershor 2023, pas kërkesës së tij drejtuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë.

15. Më 31 korrik 2023, kërkuari depozitoi ankim kushtetues të cilin Gjykata Kushtetuese mori vendim moskalimi në seancë gjyqësore më 13 tetor 2023, për shkak se ishte depozituar jashtë afatit kohor katërmujor, duke e llogaritur afatin nga data e marrjes së vendimit të Gjykatës së Lartë.

VIII. KUQO, nr. 26336/24

16. Çështja ka të bëjë me një mosmarrëveshje civile ndërmjet kërkuarit dhe një institucioni financiar. Gjykata e Apelit vendosi në favor të kërkuarit. Më 24 prill 2014, pala kundërshtare depozitoi rekurs në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë e mbledhur *in camera* shfuqizoi vendimin e gjykatës së apelit më 11 prill 2022. Më 1 korrik 2022, avokati i kërkuarit i dha Gjykatës së Lartë adresën e postës elektronike të tij. Vendimi i Gjykatës së Lartë u publikua në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë më 30 shtator 2022. Pas kërkesës së avokatit të kërkuarit për çështjen e këtij të fundit, Gjykata e Lartë i dërgoi vendimin me shkresën e datës 15 mars 2024, dhe avokati i kërkuarit e mori më 20 mars 2024.

17. Më 20 mars 2024, kërkuari depozitoi ankim kushtetues për të cilin Gjykata Kushtetuese mori vendim moskalimi në seancë gjyqësore më 9 maj 2024, për shkak se ishte depozituar jashtë afatit kohor katërmujor, duke e llogaritur afatin nga 30 shtatori 2022.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

18. Duke pasur parasysh objektin e ngjashëm të kërkesave, Gjykata e gjen të përshtatshme t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

19. Gjykata vëren se ankimet e kërkuarëve, në lidhje me të drejtën e tyre për t'ju dërguar Gjykatës Kushtetuese nuk janë haptazi të pabazuara sipas kuptimit të nenit 35 paragrafi 3 (a) të Konventës ose të papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Prandaj, ato duhet të shpallen të pranueshme.

20. Parimet e përgjithshme, në lidhje me të drejtën për t'ju drejtuar një gjykatë dhe, në veçanti, për t'ju drejtuar gjykatave më të larta janë përmbledhur në çështjen *Zubac kundër Kroacisë* ([DHM], nr. 40160/12, §§ 76–99, 5 prill 2018).

21. Gjykata më parë ka gjetur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës kur afati katërmujor për paraqitjen e ankimit kushtetues ishte llogaritur nga data e marrjes së vendimit të kontestuar të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data e njoftimit të tij te kërkuari (shihni *Supergrav Albania sh.p.k.* nr. 20702/18, §§ 17–31, 9 maj 2023).

22. Gjithashtu, Gjykata vëren që Gjykata Kushtetuese ishte shprehur që kur një palë kërkonte të merrte vendimin e Gjykatës së Lartë, në kopjen e vendimit vendosej data e shpalljes së vendimit. Sipas Gjykatës Kushtetuese, kjo nuk provonte që palës nuk i ishte njoftuar vendimi më herët. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk sqaroi në çfarë mënyre një palë mund të jepte një provë pozitive të datës së njoftimit të parë (krahasoni *Aždajić kundër Sllovenisë* nr. 71872/12, § 69, 8 tetor 2015), ose arsyen se pse barrën e provës në këtë drejtim duhej ta kishte vetëm njëra palë. Gjykata vlerëson se fillimisht i takon Gjykatës së Lartë të sigurohet që në dosjen e saj të çështjes të ketë prova për datën e njoftimit të vendimit të saj te palët (shihni *mutatis mutandis*, *Zela kundër Shqipërisë* nr. 33164/11, § 38, 11 qershor 2024) Edhe kur vendimet e Gjykatës së Lartë publikohen në faqen e saj të internetit, afati kohor për depozitimin e ankimit kushtetues llogaritet nga data e marrjes dijeni të kërkuarit për vendimin e Gjykatës së Lartë (krahasoni *Supergrav Albania sh.p.k.*, cituar më lart, § 29).

23. Qeveria pretendoi se as kërkuarit, as avokatët e tyre nuk i dhanë Gjykatës së Lartë adresat e postës së tyre elektronike për qëllim të dërgimit të vendimeve të asaj gjykatë me postë

elektronike. Megjithatë, në të gjitha kërkesat, ankimet në Gjykatën e Lartë ishin dorëzuar përpara fundit të majit 2021, kur në legjislacionin e brendshëm u prezantua mundësia e dërgimit të vendimeve të Gjykatës së Lartë me postë elektronike.

24. Më tej, në kërkesat nr. 26353/23, 4427/24 dhe 26336/24, avokatët e kërkuësve i dhanë Gjykatës së Lartë adresat e postës së tyre elektronike.

Në kërkesën nr. 26353/23, kërkuësi pretendoi se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i ishte dërguar avokatit të tij me postë elektronike dhe Qeveria nuk e kundërshtoi këtë pretendim.

Në kërkesën nr. 26336/24, Gjykata e Lartë e mori vendimin më 11 prill 2022. Avokati i kërkuësit i dha Gjykatës së Lartë adresën e tij të postës elektronike më 1 korrik 2022. Gjykata e Lartë publikoi vendimin e plotë të arsyetuar në faqen e saj të internetit më 30 shtator 2022, por nuk ia dërgoi avokatit të kërkuësit me postë elektronike.

25. Nisur nga rrethanat më sipër, Gjykata del në përfundimin që gjen shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës, në lidhje me të drejtën e kërkuësit për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

III. ANKIMET E MBETURA

26. Në kërkesën nr. 17829/23, kërkuësi u ankua, gjithashtu, sipas nenit 6 për mungesën e drejtësisë të proceseve penale kundër tij.

27. Në kërkesën nr. 19482/23, kërkuësi u ankua, gjithashtu, sipas nenit 6 për mungesën e drejtësisë të proceseve penale në Gjykatën e Lartë.

28. Në kërkesën nr. 19983/23, kërkuësi u ankua, gjithashtu, sipas nenit 6 për mungesën e drejtësisë të proceseve penale kundër tij.

29. Në kërkesën nr. 26353/23 kërkuësi u ankua sipas nenit 8 të Konventës që ishte shkelur e drejta e tij për respektimin e jetës së tij private.

30. Në kërkesën nr. 38576/23 kërkuësja u ankua sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 që ishte shkelur e drejta e saj për gëzimin paqësor të pasurisë së saj.

31. Në kërkesën nr. 4427/24 kërkuësja u ankua sipas nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 4 për mungesën e drejtësisë të proceseve penale kundër saj dhe ndalimin e burgimit të saj për borxhin.

32. Në kërkesën nr. 6470/24 kërkuësi u ankua sipas nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 për mungesën e drejtësisë së proceseve civile dhe për të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pasurisë së tij.

33. Në kërkesën nr. 26336/24 kërkuësi u ankua sipas nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 për mungesën e drejtësisë së proceseve civile dhe për të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pasurisë së tij.

34. Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 të Konventës sa kohë që mënyra se si Gjykata Kushtetuese kishte interpretuar afatin kohor për depozitim të ankimit kushtetues privonte të drejtën e kërkuësve për t'iu drejtuar gjykatës. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk shqyrtoi themelet e ankimeve kushtetuese të kërkuësve.

35. Duke pasur parasysh gjetjen e saj, në lidhje me të drejtën e kërkuësve për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese, sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës (shihni paragrafin 25 më lart), Gjykata vëren se tani kërkuësit kanë mundësi të kërkojnë rihapjen e proceseve përpara asaj gjykate. Kjo e fundit do të lejonte shqyrtimin e ankimeve të mbetura të kërkuësve sipas Konventës (shihni, për shembull, në lidhje me mundësinë e Gjykatës Kushtetuese për të trajtuar ankimet për gjykim të drejtë *Muçaj kundër Shqipërisë* [Komiteti] nr. 37814/10, § 26, 11 korrik 2023, me referenca të mëtejshme). Gjykata nuk mund të spekulojë për rezultatin e këtyre proceseve. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se ankimet e mbetura të kërkuësve janë të parakohshme dhe duhet të refuzohen në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës (shihni *mutatis mutandis*, *Baljak dhe të tjerë kundër Kroacisë* nr. 41295/19, §§ 45–46, 25 nëntor 2021).

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

36. Kërkuesit në kërkesat nr. 19482/23, 19983/23, 38576/23, 6470/24 dhe 26336/24 kërkuan kompensim në shuma të ndryshme për dëmin pasuror dhe jopasuror. Kërkuesi në kërkesën nr. 26353/23 kërkoi dëmshpërblim jopasuror, por e la shumën e dëmshpërblimit në diskrecion të Gjykatës. Kërkuesit në kërkesat nr. 19482/23, 26353/23, 38576/23, 6470/24 dhe 26336/24, gjithashtu, paraqitën kërkesa për kosto dhe shpenzime për përfaqësimin e tyre në procese përpara gjykatave të brendshme dhe Gjykatës.

37. Kërkuesit e tjerë nuk paraqitën kërkesa për dëmshpërblim, apo për kosto dhe shpenzime.

38. Qeveria i kundërshtoi këto shuma.

39. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së gjetur dhe dëmit pasuror të pretenduar; prandaj i refuzon këto kërkesa. Gjykata për secilin kërkues në kërkesat nr. 19482/23, 19983/23, 26353/23, 38576/23, dhe 6470/24 cakton shumën 3,600 euro (EUR), dhe për kërkuesin e kërkesës nr. 26336/24 cakton shumën 3,000 euro (sipas pretendimit), në lidhje me dëmshpërblimin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet kërkuesve.

40. Gjykata, duke pasur parasysh dokumentet në dispozicion të saj dhe praktikën e saj gjyqësore, refuzon kërkesat për kosto dhe shpenzime në procese gjyqësore të brendshme (krahasoni *Supergrav Albania sh.p.k.*, cituar më sipër, § 38). Ajo e vlerëson të arsyeshme që për kërkuesit e kërkesave nr. 19482/23, 26353/23 dhe 6470/24 të caktojë si dëmshpërblim shumën prej 2,000 eurosh, dhe për kërkuesin e kërkesës nr. 26336/24, shumën prej 1,855 eurosh, sipas pretendimit, në lidhje me kosto dhe shpenzime, plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet kërkuesve.

41. Gjykata rrëzon pretendimin për kosto dhe shpenzime në kërkesën nr. 38576/23, sepse kërkuesja nuk kishte përfaqësim ligjor në procese përpara Gjykatës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. *Vendos* të bashkojë kërkesat;

2. *Shpall* të pranueshme ankimet, në lidhje me të drejtën e kërkuesve për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe të papranueshme pjesën tjetër të kërkesave;

3. *Vendos* që është shkelur paragrafi 1 i nenit 6 të Konventës për të drejtën e kërkuesve për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese;

4. *Vendos*:

a) që shteti i paditur t'u paguajë kërkuesve, brenda tre muajve, shumën e treguar në tabelën bashkëngjitur, që do të konvertohet në monedhën e shtetit të paditur me normën në fuqi në datën e shlyerjes;

b) nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme, sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje;

5. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesve për shpërblim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 31 mars 2026 sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
PRESIDENT

Úna Ní Raifeartaigh
ZËVENDËSKANCELAR NË DETYRË

SHTOJCË

Nr.	Kërkesa nr. Depozituar më	Emri i çështjes	Kërkues Viti i lindjes Vendi i qëndrimit Shtetësia	Përfaqësuar nga	Shuma e shpërblimit të drejtë (në euro) ¹	Shuma e kostove dhe shpenzimeve (në euro) ²
1.	17829/23 27.4.2023	Lepuri kundër Shqipërisë	Mirash LEPURI 1973 Shkodër Shqiptar	Klodjan RECI	-	-
2.	19482/23 5.5.2023	Braho kundër Shqipërisë	Arian BRAHO 1970 Tiranë Shqiptar	Gentian NEBI AJ	3.600	2.000
3.	19983/23 12.5.2023	Kule kundër Shqipërisë	Perikli KULE 1968 Korçë Shqiptar	Gianluca PIEMONTE	3.600	-
4.	26353/23 28.6.2023	Malltezi kundër Shqipërisë	Jamarber MALLTEZI 1972 Tiranë Shqiptar	Ledi BIANKU	3.600	2.000
5.	38576/23 18.10.2023	Guralumi kundër Shqipërisë	Margarita GURALUMI 1939 Tiranë Shqiptare	-	3.600	-
6.	4427/24 2.2.2024	Çela kundër Shqipërisë	Ornela ÇELA 1971 Tiranë Shqiptare	Ndue PJETRA	-	-
7.	6470/24 23.2.2024	Balla kundër Shqipërisë	Shyqiri BALLA 1949 Bulqizë Shqiptar	Ahmet JANGULLI	3.600	2.000
8.	26336/24 10.9.2024	Kuqo kundër Shqipërisë	Taulant KUQO 1987 Princeton, SHBA Shqiptar	Gjergji NOLE	3.000	1.855

¹ Plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet kërkuesve.

² Plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet kërkuesve.

